

UDHËZIM

Nr., datë2019

PËR PROCEDURAT STANDARDE TË APLIKIMIT DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN E FONDEVE NGA BUXHETI I SHTETIT PER PROGRAMET E STREHIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 69, pika 2, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 1.6.2016, “Për miratimin e strategjisë së strehimit social 2016–2025”, ministri i Financave dhe Ekonomisë:

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, afateve dhe kriterëve të aplikimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për përfitimin e fondeve të planifikuara në ligjin vjetor të buxhetit, në programin buxhetor “strehimi”.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqesin aplikimet e tyre çdo vit me qëllim përfshirjen e kërkesave të tyre për mbështetje nga fondet buxhetore në projekt-buxhetin afatmesëm. Aplikimi për t’u përfshirë në projekt buxhetin afat-mesëm bëhet brenda afateve të parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor, dhe shoqërohet me të dhënat e tabelës nr. 1. Ky aplikim përmban kërkesat buxhetore për realizimin e një apo disa programeve të strehimit social, sipas nenit 11 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe/ose për mbështetje me instrumente financiare sipas Kreut V dhe neneve 42, 46, 47 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, si edhe për mbështetje për realizimin e formave të bashkëpunimit dhe partneritetit shtet-privat.

Tabela nr. 1

Kategoria 1 ¹ :				
Titulli i Projektit ²				
Lloji i Produktit	Familje të strehuara			
Njësia Matëse	Numër			
	2019 Buxheti	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi
Sasia e produktit (nr. familje)				
Kosto totale e projektit (në mijë lekë)				
Buxheti i bashkisë				
Financim nga donatorë				
Kërkesa për mbështetje buxhetore				

3. Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent bëhet brenda muajit janar të çdo viti, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Ky aplikim shoqërohet me të dhënat sipas tabelës nr. 2.

¹ Kategoria: 1) Shpenzime korrente; 2) Shpenzime kapitale (230 ose 231)

² Vendoset titulli i projektit për të cilin aplikohet, ose e instrumentit financiar, p.sh. Projekti i përmirësimit të banesave” (shpenzime kapitale), ose “Subvencionimi i qirasë (shpenzime korrente)

Tabela nr. 2 Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit

Njësia e vetëqeverisjes vendore _____

Nr.	Lloji i informacionit	PO	JO	Pjesërisht	Sqarime/ Komente/informacion
1	Disponon në pronësi banesa sociale me qira				Numri i banesave sociale që disponon Bashkia
2	Zotëron fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg				Sasia e fondeve që do të vëre në dispozicion
3	Ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave				Vlera mesatare e shit-blejes së banesave në treg sipas strukturave të apartamenteve
4	Ka në dispozicion të programit banesa në pronësi të pronarëve socialë				Numër, ose sqarime të tjera
5	Ka ngritur strukturën përgjegjëse për strehimin				
6	Ka hartuar programin 5-vjeçar për strehimin				
7	Ka vlerësuar nevojat për strehim				
8	Ka dërguar informacionin vjetor sipas shkronjës “dh”, të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 22/2018				
9	Fonde për subvencionimin e qirasë të vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore				
10	Popullsia e regjistruar në 1 janar të vitit të mëparshëm				
11	Të ardhurat e veta të bashkisë të vitit të mëparshëm				

4. Të dhënat sipas pikave 1, 2, 3, 4, 9, 10 e 11 të tabelës nr. 2 të këtij udhëzimi janë informuese dhe shërbejnë për të argumentuar llojin e programit për të cilin aplikon njësia e vetëqeverisjes vendore dhe përqindjen e financimit. Të dhënat që dalin nga raporti i pikës 11 me pikën 10 të tabelës, njësia e vetëqeverisjes vendore i konfirmon pranë strukturës përgjegjëse për financat vendore në ministrinë përgjegjëse për financat.
5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk plotësojnë kushtet sipas pikave 5, 6, 7 e 8 të tabelës nr. 2 të këtij udhëzimi skualifikohen nga përfitimi i fondeve për ndërtimin e banesave sociale ose të banesave me kosto të ulët.
6. Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent respekton edhe rregullat si më poshtë:
 - a. Për të përfituar mbështetje për subvencionimin e qirasë për banesa sociale në tregun e lirë, njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë brenda dy javëve të para të muajit janar. Formati i aplikimit është sipas VKM, Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”.
 - b. Për të përfituar grant të menjëhershëm, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si rregull duhet të aplikojnë sipas afateve të përcaktuara në germën (a) të kësaj pike, me përjashtim të rasteve kur situatat e krijuara për përfitimin e grantit të menjëhershëm janë krijuar më pas dhe nuk janë parashikuar në kohë.
 - c. Për të përfituar fonde investimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t’i përgjigjen

thirrjes që shpall ministria përgjegjëse për strehimin, ku përcaktohen afatet kohore për dorëzimin e projekteve, dokumentacioni që duhet të dorëzohet njësisë e vetëqeverisjes vendore, informacioni që duhet të shoqërojë aplikimin, kriteret skualifikuese dhe sistemi i pikëzimit për kualifikimin e fituesve të garës.

7. Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore janë në varësi të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr. 3, dhe në raport të drejtë me numrin e aplikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përkundrejt totalit të aplikimeve në shkallë vendi.

Tabela nr. 3

Nr.	Të ardhurat për frymë të NJVV(/000 lekë)	Forma e financimit
		Grant i kushtëzuar
1	me të ulëta se 2,000	Deri 100%
2	2,001 – 4,000	Deri 80%
3	4,001 – 6,000	Deri 70%
4	6,001 – 8,000	Deri 60%
5	Mbi 8,001	Deri 50%

8. Shqyrtimi, vlerësimi dhe miratimi i projektpropozimeve, sipas pikës 6, germa “c”, të këtij udhëzimi bëhet nga një komision i ngritur në ministrinë përgjegjëse për strehimin, i përbërë nga:
 - a. Zëvendësministri që mbulon çështjet e strehimit, në ministrinë përgjegjëse për strehimin,kryetar;
 - b. Drejtori i Përgjithshëm që mbulon çështjet e strehimit në ministrinë përgjegjëse për strehiminanëtar;
 - c. Drejtori i Përgjithshëm që mbulon çështjet e buxhetit në ministrinë përgjegjëse për strehiminanëtar;
 - ç një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për çështjet socialeanëtar;
 - d. një përfaqësues i shoqatave që përfaqësojnë autoritetet vendore..... anëtar;
 - dh. një përfaqësues i shoqatave që mbrojnë interesat e grupeve të veçanta, si minoriteti Rom dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, gra të dhunuara, etj., mund të ftohet për të marrë pjesë në komision, pa të drejtë vote.
9. Ministria përgjegjëse për strehimin i drejtohet çdo vit me shkrim shoqatave të përmendura në germën ‘d’ dhe ‘dh’ të pikës 8 të këtij udhëzimi për të propozuar përfaqësuesit e tyre. Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqatave sipas këtyre germave realizohet nga ministria përgjegjëse për strehimin, në bazë rotacioni.
10. Komisioni ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin në fuqi për organet kolegjiale dhe miraton vendimet e veta me shumicë të thjeshtë.
11. Struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin ushtron kompetencat e sekretariatit të komisionit të ngritur sipas pikave 8 dhe 9 të këtij udhëzimi. Struktura përgjegjëse ngarkon shprehimisht një punonjës të vetin që të ushtrojë detyrën e sekretarit të komisionit, si dhe një zëvendësues të tij/saj, në rastet e pamundësisë së ushtrimit të funksionit nga i pari.
12. Me përfundimin e afatit të aplikimit, struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin përpunon dokumentacionin e aplikimit të ardhur nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore dhe, brenda 45 ditëve pune, përgatit një raport përmbledhës, përfshirë një vlerësim paraprak. Në rastet kur numri i aplikimeve është i madh, afati i përfundimit të raportit mund të shtyhet edhe 15 ditë të tjera pune. Raporti përmbledhës përmban:

- a. përshkrimin e projekteve të paraqitura;
 - b. statistika mbi llojin e projekteve të propozuara, numrin dhe kategoritë e përfituesve, dhe çdo të dhënë tjetër që ka shërbyer për të bërë vlerësimin paraprak;
 - c. problemet e ndeshura;
 - ç. mënyrën e aplikimit të sistemit të pikëzimit për përgatitjen e renditjes paraprake të propozimeve;
 - d. projektet e skualifikuara, nëse ka, dhe arsyet e skualifikimit të tyre;
 - dh. çdo informacion tjetër të nevojshëm.
13. Komisionit i paraqitet raporti përmbledhës i hartuar sipas pikës 12 të këtij udhëzimi, dhe aplikimet e plota, të paktën 5 ditë pune përpara datës së mbledhjes.
14. Komisioni ka për detyrë të:
- a. njihet me raportin e përgatitur sipas pikës 12 të këtij udhëzimi dhe aplikimet e plota të njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - b. miratojë projektet fituese që do të financohen nga buxheti i shtetit me vendim, i cili shoqërohet me tabelën përfundimtare të ndarjes së fondeve;
 - ç. të dokumentojë me procesverbal mbledhjen.
15. Në përcaktimin e fituesve të projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit në një vit buxhetor, Komisioni mund të klasifikojë një numër të kufizuar fituesish, ose mund të klasifikojë të gjitha projektet si fituese kur ndryshimet mes cilësisë, përmbajtjes, qëllimit, prioritetit a kritereve të tjera nuk janë tepër të dallueshme.
16. Në rastin kur fondet e akorduara në një vit buxhetor janë të pamjaftueshme për të mbështetur me financim apo bashkëfinancim kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore, struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin i propozon Komisionit, ndarjen e financimit në vite, por në jo më shumë se në dy vite, përveç rastit të projekteve madhore, të cilat miratohen me procedura të veçanta nga ministri përgjegjës për strehimin.
17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

RELACION

PËR PROJEKT UDHËZIMIN

PËR PROCEDURAT STANDARDE TË APLIKIMIT DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN E FONDEVE NGA BUXHETI I SHTETIT PER PROGRAMET E STREHIMIT

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektudhëzimi "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit per programet e strehimit" propozohet në zbatim të nenit 69, pika 2, të ligjit 22/2018, "Për strehimin social", me qëllim për qëllim të detajojë procedurat standarde të aplikimit si dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit per programet e strehimit sipas ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektudhëzimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektudhëzimi nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me VKM Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", por ai parashikohet si detyrim ligjor i parashikuar nga neni 69, pika 2, e ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'.

Gjithashtu, projektakti plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Vendimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave. Kjo Strategji nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një kuadri ligjor të ri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektudhëzimi " Për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 69, pika 2. Projektudhëzimi sqaron kriteret që duhet të përdoren për vlerësimin e aplikimit të njësive të vetëqeverisjes vendore për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit për programet e strehimit sipas ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social' si dhe procedurat standarde të aplikimit në këto raste. Në vazhden e projektakteve të tjera zbatuese të këtij ligji, projektudhëzimi plotëson kuadrin ligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe ofrimin e rregullave të nevojshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore që të mundësojnë fondet e nevojshme për garantimin e një strehimi social sa më të përshtatshëm dhe që plotëson kërkesat e personave në nevojë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektudhëzimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës:* Akti i propozuar propozohet nga një organ kushtetues (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) dhe miratohet po nga ai organ (Ministri i Financave dhe Ekonomisë), i cili ka tagrin të miratojë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 69, pika 2 të ligjit nr. 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Udhëzim i Ministrit), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.
- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit:* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 69, pika 2 e ligjit nr. 22/2018 parashikon se: "[m]ënyra e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit miratohen me udhëzim të ministrit të linjës, që ka në dispozicion fondet". Ky parashikim adresohet plotësisht në titull si edhe në përmbajtjen e projektaktit.
- c) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë përgjegjës për strehimin propozon dhe miraton aktin.

- d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me to.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektudhëzim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektudhëzimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim përcaktimin e mënyrës së aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit.

Projektudhëzimi është i strukturuar në 17 pika. Pika 1 përcakton qëllimin e udhëzimit që është përcaktimi i rregullave, afateve dhe kriterëve të aplikimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për përfitimin e fondeve të planifikuara në ligjin vjetor të buxhetit, në programin buxhetor “strehimi”.

Në vijim, pika 2 dhe 3 qartëson aspekte procedurale ku përfshihen:

- Aplikimet për mbështetje nga fondet buxhetore bëhen çdo vit me qëllim përfshirjen e kërkesave në projekt-buxhetin afatmesëm
 - o afatet për aplikim respektojnë legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor
 - o aplikimet shoqërohen me të dhëna të ku përfshihen info për titullin e projektit, familjet që përfitojnë, buxhetin e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore, financimin nga donatorë në kuadër të partneritetit shtet-privat, kërkesën për mbështetje buxhetore.
- Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent bëhet brenda muajit janar të çdo viti, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor
 - o aplikimi shoqërohet me të dhëna të detajuara të gjendjes së strehimit social në njësinë e vetëqeverisjes vendore, apo edhe të dhëna të popullatës, apo edhe fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Projektudhëzimi për të lehtësuar aplikimin ka të përfshirë në tekstin e vet edhe tabelat përfundimtare, të gatshme për t'u plotësuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në vijim, pikat 3 dhe 4 të projektudhëzimit qartësojnë rëndësinë dhe vlerën që kanë të dhënat e tabelave për vetë aplikimin, duke sqaruar edhe të dhënat të cilat nëse nuk respektohen çojnë në skualifikimin e aplikimeve. Pika 5 përcakton rregulla duke iu referuar edhe kuadrit ligjor e nënligjor të miratuar tashmë për të përfituar nga buxheti i shtetit subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, grant të menjëhershëm, apo fonde investimi. Pika 6 i referohet një kriteri objektiv për financimin, siç është ai i të ardhurave për frymë dhe numri i aplikimeve të çdo njësite të vetëqeverisjes vendore përkundrejt totalit të aplikimeve në shkallë vendi, duke përshkallëzuar proporcionalisht masën e financimit me të ardhurat për frymë.

Pikat 7 deri 10 parashikojnë se për vlerësimin e aplikimeve, proceduralisht krijohet një komision, i cili në përbërje ka përfaqësues të institucioneve që kanë në fushën e përgjegjësisë çështje të strehimit, financave, çështjet sociale, por edhe të shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore me qëllim përfshirjen e grupeve të interesit në vendimmarrje dhe përcaktojnë rregullat e funksionimit të komisionit si një organ kolegjal, në respektim të legjislacionit në fuqi për organet kolegjinale. Në këto pika parashikohet edhe se struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin ushtron kompetencat e sekretariatit të komisionit. Pika 11 parashikon se struktura përgjegjëse për strehimin në ministrinë përgjegjëse për strehimin përpunon dokumentacionin e aplikimit të ardhur nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore dhe përgatit një raport përmbledhës, përfshirë një vlerësim paraprak i cili i paraqitet komisionit për vendimmarrje.

Udhëzimi në pikën 15 dhe 16 qartëson disa rregulla për numri e fituesve duke theksuar se mund të klasifikohen të gjitha projektet si fituese kur ndryshimet mes cilësisë, përmbajtjes, qëllimit, prioritetit a kriterëve të tjera nuk janë tepër të dallueshme, si dhe se kur fondet e akorduara në një vit buxhetor janë të pamjaftueshme mudn të ndahet financimi deri në dy vite, përveç kur ka projekte madhore që miratohen me procedura të veçanta nga ministri përgjegjës për strehimin.

Pika 17 përcakton institucionet apo strukturat e ngarkuara me zbatimin e këtij projektakti. Në fund parashikohet, në përputhje me Kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektudhëzimi ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektudhëzim u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin dhe UNDP-së, me asistencën e ekspertëve kombëtarë të kontraktuar nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së i cili diskutoi intensivisht dhe konsultoi projektaktin paraprakisht me punonjës të minsitrive të përmendura dhe entit kombëtar të banesave në takime të vazhdueshme dhe periodike. Draftet e përgatitur nga ekspertë u rishikuan disa herë në takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në to çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme. Grupi i punës dhe ekspertët analizuan edhe aktet nënligjore përkatëse që kanë mbuluar rregullimet e këtij projektudhëzimi për të konstatuar nga pikëpamja historike zhvillimin e rregullimit ligjor.

Drafti iu nënshtrua, në përputhje me ligjin për konsultimin publik në fuqi në vend, procesit të konsultimit publik, transparent dhe gjithëpërfshirës përmes <http://www.konsultimipublik.gov.al/>. Përgjatë këtij procesi u paraqitën këto sugjerime, të cilat u (mënyra si u adresuan).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me kostot institucionale, projektudhëzimi nuk kërkon ndryshim të numrit të të punësuarve pranë njësisve të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të qeverisjes qendrore të ngarkuara me zbatimin e këtij udhëzimi.

MINISTRI

Anila Denaj